




Republika e Kosovës  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Kuvendi - Skupština - Assembly



<b>PËR/ZA/TO</b>	Z. Isa Mustafa Kryeministër i Qeverisë së Kosovës	<b>DATE DATUM DATE</b>	13.06.2016
		<b>Reference</b>	
<b>NGA/OD/FROM</b>	Faton Topalli, deputet i GP Lëvizja VETËVENDOSJE! <i>Faton Topalli</i>		
<b>SUBJEKTI PREDMET SUBJECT</b>	Pyetje për përgjigje me gojë		

Në bazë të Rregullës 45 pika(2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëj pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

**ÇËSHTJA:**

z. Kryeministër

Është bërë e ditur që prej 483 pjestarëve të Mbrojtjes Civile, vetëm pak prej tyre kanë filluar punën dhe marrin rrogat e tyre kot.

**PYETJA PARLAMENTARE:** Kur do të fillojnë punën pjestaret e Mbrojtjes Civile? A ka qeveria plan për angazhimin e tyre, kur dhe ku do të angazhohen ata?





Republika e Kosovës  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Kuvendi - Skupština - Assembly

REPUBLIC OF KOSOVO - REPUBLIKA KOSOVO-REPUBLIC OF KOSOVO  
KUVENDI I REPUBLIKES SË KOSOVËS  
SKUPŠTINA REPUBLIKE KOSOVA  
ASSEMBLY OF REPUBLIC OF KOSOVO  
Evropa për Propozime dhe Propozime të Propozimeve të Propozimeve  
Mr. Prop. 05/2183/10-1093  
Date: 13.06.2016  
PRISTINE - PRISTINA - PRISTINA

<b>PËR / ZA / TO</b>	Z. Skënder Hyseni Ministër i Punëve të Brendshme	<b>DATE DATUM DATE</b>	13.06.2016
		<b>Reference</b>	
<b>NGA / OD / FROM</b>	Faton Topalli, deputet i GP Lëvizja VETËVENDOSJE! <i>Faton Topalli</i>		
<b>SUBJEKTI PREDMET SUBJECT</b>	Pyetje për përgjigje me gojë		

Në bazë të Rregullës 45 pika(2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëj pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

#### ÇËSHTJA:

Dihet që pas largimit të 100 000 qytetarëve të Kosovës në dhjetor 2014 dhe Janar 2015, ka filluar menjëhe rikthimi i tyre.


#### PYETJA PARLAMENTARE

Sa është numri i të kthyerve nga vendet Perëndimore prej Shurtit 2015 deri më 30 maj 2016?  
Nga cilat vende kthehen ata dhe a ka Qeveria e Kosovës dhe vendet prej të cilave kthehen ata plan për integrimin e tyre?





Republika e Kosovës  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Kuvendi - Skupština - Assembly



<b>PËR / ZA / TO</b>	Z. Memli Krasniqi Ministër i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	<b>DATE DATUM DATE</b>	14.06.2016
		<b>Reference</b>	
<b>NGA / OD / FROM</b>	Salih Salihu, deputet i GP Lëvizja VETËVENDOSJE! 		
<b>SUBJEKTI PREDMET SUBJECT</b>	Pyetje për përgjigje me gojë		

Në bazë të Rregullës 45 pika(2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëj pyetje për përgjigje me shkrim në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.


### ÇËSHTJA

Z. ministër, përgjatë gjithë këtyre viteve toka bujqësore është uzurpuar dhe dëmtuar nga ndërtimet e vrazhda që janë bërë duke shkelë legjislacionin në fuqi në Kosovë. Janë betonuar sipërfaqe të mëdha të tokave të punëshme duke u shndërruar në zona industriale, shtëpi private e hotele përkundër që këto çështje janë të rregulluara edhe me Ligjin për Tokat bujqësore.

### PYETJA PARLAMENTARE:

Z. ministër, cilat veprime i keni ndërmarrë deri më tani dhe çka jeni duke planifikuar për këto shqetësime?





Republika e Kosovës  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Kuvendi - Skupština - Assembly

<b>PËR / ZA / TO</b>	Z. Kujtim Shala Ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sportit	<b>DATE DATUM DATE</b>	14.06.2016
		<b>Reference</b>	
<b>NGA / OD / FROM</b>	Mytaher Haskuka, deputet i GP Lëvizja VETËVENDOSJE!		
<b>SUBJEKTI PREDMET SUBJECT</b>	Pyetje për përgjigje me gojë		

Në bazë të Rregullës 45 pika(2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëj pyetje për përgjigje me shkrim në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

### Çështja

Javën e kaluar në Prizren ndodhi një tragjedi ku humbi jetën një 3 vjeçare dhe u lënduan dy të tjerë, kjo fatkeqësi është pasoje e mosveprimit të pushtetit lokal dhe asaj qendror të cilat janë të obliguara të mbrojnë monumentet e trashëgimisë kulturore sipas Ligjit Nr. 02/L-88 për Trashëgiminë Kulturore dhe sipas Ligjit Nr. 04/ L-066 për Qendrën Historike të Prizrenit. Të përkujtoj në vitet e kaluara shumë organizata joqeveritare dhe opozita në Prizren ka kërkuar që institucionet kompetente, që në këtë rast janë Komuna e Prizrenit dhe Ministria e Kulturës, Sportit dhe Rinisë (MKRS) të veprojnë dhe të mbrojnë qendrën historike të Prizrenit sipas përgjegjësisë që i përcaktojnë ligjet.

Po ashtu Këshilli i Trashëgimisë Kulturore për Qendrën Historike të Prizrenit që me datën 9 prill 2016, duke e paraparë rrezikun ka kërkuar që MKRS të ndajë fonde emergjente për të ndërhyrje dhe riparime tek objektet e rrezikuara nga shembja.

### Pyetja parlamentare

Pse MKRS-ja asnjëherë nuk i ka marrë parasysh këto kërkesa dhe nuk ka vepruar për të mbrojtur trashëgiminë kulturore në qendrën historike të Prizrenit? Pse nuk janë ndarë fonde të kërkuara për sanimin e gjendjes? A duhen më shumë viktima që qeveria të kryej obligimet e saja ndaj qytetarëve ashtu si përcaktojnë ligjet e cekuar më lartë?





Republika e Kosovës  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Kuvendi - Skupština - Assembly

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVO-REPUBLIC OF KOSOVO  
KUVENDI I REPUBLIKES SE KOSOVES  
SKUPSTINA REPUBLIKE KOSOVA  
ASSEMBLY OF REPUBLIC OF KOSOVO  
Zyra për Propozime dhe Përshkrima - Kancelaria za Predloge i Prishtoves - Table Office

No. Prop. 05/2193/Do-1/01  
No. Prop. 05/2193/Do-1/01  
No. Prop. 05/2193/Do-1/01

Data  
Datum  
Date 14.06.2016

PRISHTINË - PRISTINA - PRISTINA

<b>PËR / ZA / TO</b>	Z. Isa Mustafa Kryeministër i Qeverisë së Kosovës	<b>DATE DATUM DATE</b>	13.06.2016
		<b>Reference</b>	
<b>NGA / OD / FROM</b>	Donika Kadaj Bujupi, deputete e GP Lëvizja VETËVENDOSJE!		
<b>SUBJEKTI PREDMET SUBJECT</b>	Pyetje për përgjigje me gojë		

Në bazë të Rregullës 45 pika (2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëj pyetje për përgjigje me shkrim në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

**ÇËSHTJA:**

z. Kryeministër, ditëve të fundit, drejtori i të ashtuquajturës Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë ka deklaruar se “brenda një kohë të shkurtër do të vihet guri themeltar në lokacionin e përgatitur për ndërtim e Luginës së Diellit në Mitrovicën Veriore”. Në lidhje me këtë ju keni deklaruar se ata nuk kanë të drejtë ligjore dhe se institucionet nuk kanë dhënë leje për një ndërtim të këtij lloji.

**PYETJA PARLAMENTARE:** Z. Kryeministër, a mund të na thoni se cilat veprime do t'i ndërmerri për t'i parandaluar këto veprime të zyrtarëve serbë në Kosovë?